

**RAPORT I PËRVJETSHËM
PËR FUSHËN E
DREJTËSISË DHE
BARAZISË GJINORE NË
KOSOVË
2024**

qika

qika

Përmbajtja

Hyrje	5	Dhuna në familje ndaj grave	27
Përmbledhje Ekzekutive	6	Qasja në informata	29
Qasja në punësim	8	Qasja në drejtësi	30
Puna e papaguar e grave	13	Qasja në strehimore	31
Puna joformale	14	Mbështetja pas qëndrimit në strehimore.....	32
Pushimi prindëror	15	Qasja në punësim e grave që kanë përjetuar	
Qasja në pronë	16	dhunë në familje.....	33
Qasja në shëndetësi	17	Dënimet e ulëta ndaj abuzuesve	
E drejta në shëndet riprodhues		të grave	34
dhe seksual	18	Dhuna seksuale	35
Shëndeti mendor	20	Dhunimi seksual	36
Diskriminimi i ndërrhurur	21	Dhuna seksuale gjatë luftës	36
Gratë e komuniteteve etnike		Ngacmimet seksuale	39
Jo shumicë	21	Dhuna përmes teknologjisë	
Gratë LGBTI+	22	informative	42
Gratë me aftësi të kufizuara	24	Gratë në sferën publike	43
Gratë me shami	24	Femicidi	45
Dhuna me bazë gjinore	26	Zhvillimet në vitin 2024 rreth rasteve të	
Dhuna me bazë gjinore ndaj komuniteteve		tjera të femicidit në Kosovë	48
LGBTIQ+	26		

Autore: Blendë Pira

© Ky publikim është prodhuar nga Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion – QIKA, 2025

Hyrje

Ky raport vjetor përmbledh sfidat dhe zhvillimet kryesore që lidhen me drejtësinë dhe barazinë gjinore në Kosovë gjatë vitit 2024. Raporti trajton qasjen e grave në punësim, punën e papaguar dhe atë joformale, dhunën me bazë gjinore, qasjen në shërbime shëndetësore dhe sfida të tjera me të cilat përballen gratë në Kosovë. Si i tillë, raporti është pasqyrë e situatës së grave në shoqëri dhe një përmbledhje e ngjarjeve kryesore të vitit 2024 dhe fillimvitit 2025, që në fokus kishin pikërisht gratë.

Raporti është përgatitur duke analizuar burime të ndryshme, përfshirë dokumente publike, raporte të shoqërisë civile, lajme mediatike, vendime gjyqësore dhe institucionale, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore. Poashtu, janë përfshirë të dhëna të siguruara përmes kërkesave për qasje në informacione publike.

Përkundër përpjekjeve për përmirësim, arritja e barazisë gjinore mbetet sfida e madhe në Kosovë. Raporti thekson nevojën për masa më të forta institucionale dhe legjislative për të trajtuar këto çështje, duke përfshirë politika më të avancuara për punësimin, mbështetjen për gratë dhe fuqizimin e tyre ekonomik. Në të njëjtën kohë, nga të dhënat e paraqitura në raport, vërehet dukshëm nevoja për një zbatim më rigoroz të ligjeve ekzistuese për të garantuar mbrojtjen e grave dhe barazinë e tyre të plotë në shoqëri.

Përmbledhje Ekzekutive

- Në vitin 2024 u raportuan 2,959 raste të dhunës në familje, ku shumica e viktimave ishin gra;
- Në mars 2025 hyri në fuqi Udhëzimi Administrativ për Linjën Telefonike Emergjente, e cila ofron ndihmë 24 orë në ditë për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Kjo linjë pas funksionalizimit do të jetë e qasshme në nivel qendror dhe do të ndërlidhë viktimat me shërbimet përkatëse për mbrojtje dhe këshillim;
- As në vitin 2024 projekti për strehimoren për personat LGBTIQ+ nuk u jetësua. Personat transgjinorë nuk kanë qasje në terapi hormonale apo operacione afirmuese në sistemin publik, ndërsa ligji nuk u njeh të drejtën për martesë personave të të njëjtit seks;
- 3 raste të reja të femicidit u shënuan në vitin 2024;
- Ministria e Drejtësisë inicioi hartimin e Projektligjit për Femicidin;
- Qeveria e Kosovës hoqi Ligjin e Punës nga Kalendari Legjislativ;
- Në tetor 2024, Avokati i Popullit konstatoi se deklaratat e disa deputetëve në Kuvendin e Kosovës, gjatë debatit për Projekt Kodin Civil në vitin 2022, ishin diskriminuese dhe fyese ndaj komuniteteve LGBTIQ+, duke përbërë gjuhë të urrejtjes.



TRUPI
JEM
E
DREJTJA
JEM

Foto nga marshi "Marshojmë S'festojmë" 2024
Credits: Marshojmë S'festojmë

Qasja në punësim

Ndonëse gratë arrijnë mesatarisht standarde më të larta të arsimit sesa burrat, pabarazitë dhe barrierat në mundësitë e punësimit janë evidente, ku shumë gra e gjejnë veten në punë të pasigurta, me paga të ulëta, duke përjetësuar pabarazinë ekonomike.^[1]

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë në moshë pune, ndërsa shkalla e papunësisë për vitin 2024 është 10,8%.^[2]

Nga të dhënat e ASK vërehet se gjatë vitit 2024, shkalla e punësimit të gratë ishte 21,2% (1,4% më e lartë sesa në vitin paraprak), ndërsa përqindja e burrave të punësuar ishte 55,9% (2,5% më e lartë sesa në vitin paraprak).

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2024 shkalla e jo-aktivitetit ishte dukshëm më e lartë se gratë, duke arritur në 74,1%, krahasuar me 39,4% të burrave.^[3]

Në vitin 2024 Qeveria e Kosovës hoqi Ligjin e Punës nga Kalendari Legjislativ. Përmes një komunikate Forumi Ekonomik i Grave (FEG) ka kritikuar Qeverinë duke theksuar se ky vendim cënon të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Ligji ekzistues favorizon diskriminimin gjinor dhe i përjashton gratë nga tregu i punës, andaj FEG ka kërkuar që projektligji i ri të publikohet për diskutim dhe të zhvillohen konsultime me organizatat relevante.^[4]

^[1] Koha, Avancimi i Barazisë Gjinore në Kosovë: Sfidat dhe Rrugët Përpara, 2024.

^[2] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), 2024, maj 2025.

^[3] Po aty.

^[4] Forumi Ekonomik i Grave, Forum Ekonomik i Grave ka shprehur zhqendësimin e thellë ndaj Qeverisë së Kosovës, gusht 2024.

Nga të dhënat e ASK vërehet se gjatë vitit
2024, shkalla e punësimit të gratë ishte

21,2%

ndërsa përqindja e burrave të punësuar ishte 55,9%.

Shkalla e jo-aktivitetit ishte dukshëm më e lartë
të gratë, duke arritur në

74,1%

krahasuar me 39,4% të burrat.

Përkundër obligimeve të qarta që proklamon Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, një pabarazi faktike në përfaqësim në mes të burrave dhe grave në pozita të larta udhëheqëse është evidente në Kosovë. Sipas një raporti të publikuar nga organizata GAP në dhjetor të vitit 2024, ndonëse në vitet e fundit ka pasur një trend pozitiv, sidomos në përfaqësimin e grave në borde të ndërmarrjeve publike dhe pozita menaxheriale, situata vazhdon të jetë e pakënaqshme.^[5] Raporti thekson se në 14 nga 16 ndërmarrjet e analizuar, mbi 40% e anëtarëve të bordeve janë gra. Ndërkaq, në anën tjetër, përfaqësimi i grave në menaxhmentin e lartë mbetet akoma i ulët, përkundër faktit që në vitin 2023 ka pasur një rritje prej 5%.^[6]

Punëtorët teknike të Kuvendit të Kosovës, të punësuar përmes një kompanie private të pastrimit të quajtur “Schafberger” në kuadër të një kontrate për shërbime, prej gjashtë vitesh janë paguar vetëm 275 euro në muaj, me rritje të pagës vetëm dy herë nga 20 euro në tetë vjet.^[7]

Të shtyra nga këto kushte dhe nga shtypja në vendin e punës, në vitin 2024, punëtorët teknike të Kuvendit të Kosovës grevuan për më shumë se 3 muaj për të kërkuar rritje të pagës mujore nga 275 euro në 500 ose 550 euro, duke theksuar se aktualisht nuk u kompensohen shujtat, transporti dhe orari i zgjatur i punës. Një numër protestash u organizuan nga aktivistë e aktiviste në mbështetje të tyre, e thirrje të vazhdueshme për veprim u drejtuan te kuvendarët/et.^[8] Tre muaj më vonë Kuvendi i Kosovës kishte nënshkruar një kontratë të re për pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike të hapësirave të institucionit, e pas fitimit të kontratës, kompania “Schafberger” kishte zëvendësuar punëtorët teknike që ishin në grevë me

^[5] Instituti GAP, Punësimi dhe përfaqësimi i grave në ndërmarrjet publike qendrore në Kosovë, dhjetor 2024.

^[6] Po aty.

^[7] OIKA, A e dini se punëtorët teknike të Kuvendit të Kosovës paguheshin vetëm 275 euro në muaj?, 2024.

^[8] Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist, Letër publike kuvendarëve/eve për t’ju kërkuar zgjidhje të menjëhershme për grevistet, nëntor 2024.

punëtore të reja.[9]

Së fundmi Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës ka dorëzuar padi ndaj Kuvendit të Kosovës dhe kompanisë përkatëse, duke kërkuar kompensim për periudhën e grevës dhe adresimin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve.^[10]

Edhe përgjatë vitit 2024, gjuha diskriminuese dhe sulmet verbale ndaj grave në jetën publike ishin evidente.^[11] Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës në një raport të publikuar në vitin 2025 paraqet barierrat me të cilat përballën gratë gazetare për rritjen e tyre profesionale, duke listuar kështu si kryesoret: paragjykimin gjinor, mungesën e mentorimit, marginalizimin në proceset editoriale, detyrat gjinore, ngacmimin seksual në vendin e punës, balancimin e përgjegjësisë profesionale dhe personale, sigurinë e grave gazetare jashtë redaksisë, ngacmimet në terren dhe ngacmimi në internet.^[12]

[9] Kallxo.com, Greva e punëtorëve: Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat padit Kuvendin dhe Kompaninë, 2024.

[10] Po aty.

[11] Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2024, faqe 36, 20 tetor 2024.

[12] Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës, POZITA DHE SIGURIA E GRAVE GAZETARE NË KOSOVË, 2025.


JEMI NË
GREVË



Puna e papaguar e grave

Sipas një analize nga Sbunker, puna e papaguar në Kosovë përbën një të tretën ($\frac{1}{3}$) e Produktit të Brendshëm Bruto (BPV) të vendit kur ajo kthehet në një aktivitet ekonomik, e që përveç kësaj pasqyron një ndarje të theksuar gjinore dhe sociale. Analiza tregon që puna e papaguar është realiteti i përditshëm për shumë gra e që interferon me mundësinë për t'u arsimuar, punësuar dhe për të marrë pjesë në jetën publike.[13]

Sipas raportit "Who Cares? Përkujdesi si punë e papaguar në Kosovë" nga Musine Kokalari, një individ në Kosovë shpenzon mesatarisht 4.9 orë në ditë në punë përkujdesjeje të papaguar, ku gratë shpenzojnë mesatarisht 6.2 orë në ditë, ndërsa burra vetëm 3.5 orë.[14]



[13] Sbunker, *Analizë: Puna e kujdesit të papaguar në Kosovë duhet të njihet*, janar 2024.

[14] Musine Kokalari: *Who Cares? Përkujdesi si punë e papaguar në Kosovë*, 2022.

Puna joformale

Matjen e shkallës së punësimit në Kosovë e bën shumë të vështirë puna jo formale. Sipas një analize të Rrjetit të Grave të Kosovës (RRGK) të publikuar në gusht të vitit 2024, në vitin 2022 rreth 42% e kosovarëve ishin të angazhuar në punë joformale. Gratë kishin gati dy herë më shumë gjasa sesa burrat të ishin të përfshira në punë joformale, ku 56% e grave dhe 28% e burrave të anketuar ishin angazhuar në ndonjë formë pune joformale.^[15]

Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, gratë dhe burrat mbeten në ekonominë joformale për arsye nga më të ndryshmet, e ndër to janë: frika nga humbja e ndihmës sociale nëse fillojnë punësimin zyrtar, shmangia e tatimeve, rolet sociale dhe përgjegjësitë tradicionale si kujdesi në shtëpi – që rëndojnë kryesisht mbi gratë, mungesa e mbështetjes institucionale, dhe të tjera.^[16]

Ndërkohë në një hulumtim të përbashkët të Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) dhe Instituti Kosovar për Studime (IKS) raportohet se 1/3 e vendeve të punës nuk janë inspektuar kurrë për respektimin e barazisë gjinore.^[17]

^[15] Rrjeti i Grave të Kosovës, *Nën hije - Analiza gjinore e punës joformale në Kosovë, gusht 2024*, faqe 12.

^[16] Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK), *Nën hije: Analizë gjinore e punës joformale në Kosovë*, 2024.

^[17] QKSGJ dhe IKS, *STUDIM BAZË MBI DISKRIMINIMIN GJINOR NË VENDIN E PUNËS*, janar 2025, faqe 36.

Pushimi prindëror

Edhe viti 2024 u përmyll pa ndonjë zhvillim në drejtim të miratimit të Ligjit për Pushimin e Lehonisë dhe Pushimin Prindëror dhe Ligjit të ri të Punës. Në shtator 2024, Forumi Ekonomik i Grave organizoi një protestë paqësore para Qeverisë së Kosovës, duke kundërshtuar heqjen e Ligjit të Punës nga Kalendar i Legjislativ dhe duke kërkuar rikthimin e tij në programin legjislativ të vitit 2024, si dhe zhvillimin e konsultimeve publike në lidhje me të.^[18]

Modeli sipas të cilit shteti merr përsipër pagesën e pushimit të lehonisë për periudhën e parë prej 6 muajsh, ndërsa 3 muaj të tjerë kalojnë në barrën e punëdhënësit, sipas një analize të KDI do t'i kushtonte Qeverisë së Kosovës vetëm 5 milion më shumë krahasuar me buxhetin aktual për çdo vit, e që kjo do të zgjidhte një problem që po sjell diskriminim e pabarazi në punësim dhe nuk përbën një kosto të papërballeshme për shtetin, marrë parasysh çmimin që po paguajnë gratë e punësuar në Kosovë.^[19]

OKSGJ në një anketë të realizuar me 302 gra dhe 104 burra ka gjetur se nga ato/ata për të cilat/cilët ky pushim ishte relevant, dallimet gjinore në përdorimin e tij ishin të dukshme ku më shumë gra (18%) sesa burra (12%) raportuan përdorim personal të këtij pushimi.^[20]


^[18] Telegrafi, *Forum i Ekonomik i Grave paralajmëron protestë kundër Qeverisë, shkëlqë heqja e Ligjit për Punën nga kalendar i legjislativ 2024*, 2024.

^[19] Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), *Ligji i Punës në mes të nevojave dhe kërkesave për ndryshim*, maj 2024, faqe 21.

^[20] OKSGJ-IKS, *Studim bazë mbi diskriminimin gjinor në vendin e punës*, janar 2025, faqe 23.

Qasja në pronë

Në Kosovë, në vitin 2024, gratë ishin pronare të vetëm 19.8 % nga 612,482 prona të regjistruara, duke përfshirë edhe ato që i zotërojnë bashkë me burrat, e që nga viti 2010 vërehet një rritje prej 9.8 %.^[21] Ndërkohë edhe në 2024, me qëllim të rritjes së numrit të grave që kanë në pronësi prona, Qeveria e Kosovës vazhdoi të zbatojë masa afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të bashkëshortëve në regjistrin e të drejtave pronësore.^[22]



^[21] UN Woman, *Profili Gjiner i Kosovës, nëntor 2024*, faqe 57.

^[22] Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2024*, faqe 35, 20 tetor 2024.

Qasja në shëndetësi

Në shkurt të vitit 2024, për herë të parë në Kosovë filloi vaksinimi me vaksinën Human Papilloma Virus (HPV) e cila ofron mbrojtje efektive kundër kancerit të qafës së mitrës.^[23] Kanceri i qafës së mitrës është një tumor malinj që zhvillohet në mitër dhe shkaktohet pothuajse gjithmonë nga infeksioni me virusin HPV, i cili transmetohet përmes kontaktit seksual ose lëkuror.^[24] Sipas përfaqësuesve të Komunës së Prishtinës vaksinimi ka filluar të vazhdojë 11 vjeçe për shkak të efektivitetit të saj të lartë në këtë fazë.^[25] Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2025, në Kosovë janë vaksinuar mbi 13,000 fëmijë të moshës rreth 12-vjeçare, e vaksinimi do të vazhdojë edhe tek grupmoshat e tjera.^[26]

Në anën tjetër, në qershor të vitit 2024 në Kosovë ka filluar dhënia e terapisë parandaluese kundër infeksionit nga virusi HIV, përpara se të ndodhë ekspozimi ndaj tij.^[27] Kjo terapi e cila quhet PrEP, dhe është në formën e tabletave, do të mund të merret me konsultim të mjekut në Barnatorën e Klinikës Infektive.

^[23] Komuna e Prishtinës, Për herë të parë në Kosovë fillon vaksinimi HPV i vajzave kundër kancerit të qafës së mitrës, shkurt 2024.

^[24] OIKA, Kosova do të fillojë vaksinimin e vajzave 12 vjeçare kundër HPV, janar 2024.

^[25] Komuna e Prishtinës, Për herë të parë në Kosovë fillon vaksinimi HPV i vajzave kundër kancerit të qafës së mitrës, shkurt 2024.

^[26] Radio Evropa e Lirë, Vaksinimi kundër HPV-së: Mbi 13 mijë fëmijë të imunizuar në Kosovë, maj 2025.

^[27] Radio Evropa e Lirë, Në Kosovë fillon të qaset terapia për parandalimin e infeksionit nga virusi HIV, qershor 2024.

E drejta në shëndet riprodhues dhe seksual



**DEPUTETËT/ET S'KANË MANDAT
ME I CENU TRUPAT TANË!**

Në vitin 2024, përkundër thirrjeve të vazhdueshme, pecetat menstruale vazhduan të tatoheshin 18% mbi vlerën e shtuar. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare e avokimit institucional, aktiviste nga OIKA në kuadër të kampanjës "Peceta nuk është luks" shpërndanë mbi 12,000 peceta menstruale në hapësirat publike.^[28] OIKA organizoi aksione simbolike për të kërkuar heqjen e tatimit 18%, e ndër aksionet ishte edhe ai tek Qeveria e Kosovës, ku ministrit Hekuran Murati i'u dërguan 7,500 nënshkrimet e petitionit "Peceta nuk është luks" për t'i rikujtuar edhe njëherë vullnetin e qytetarëve, dhe për të treguar se produktet menstruale janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e grave.^[29]

Edhe në seancën e 26 shtatorit të vitit 2024 Kuvendi i Kosovës dështoi për të miratuar Projektligjin për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor, i cili, pavarësisht nëse gratë janë beqare, në marrëdhënie me persona të të njëjtit seks apo të seksit të kundërt, u mundëson atyre qasje në IVF.^[30]

Ministri Vitia pati premtuar që fertilizimi i asistuar mjekësor do të ofrohej edhe në sektorin publik deri në fund të vitit 2024.^[31] Aktivistë e aktiviste organizuan disa protesta para Kuvendit të Kosovës për të kundërshtuar qasjen dehumanizuese në trajtimin e kësaj çështje nga deputetët e Kosovës.^[32] Duke e kufizuar IVF-në vetëm për çiftet heteroseksuale, disa deputetë të Kuvendit të Kosovës pretendojnë se në këtë mënyrë do të mbrohet familja si institucion, duke shprehur madje frikën nga "inceste aksidentale".^[33]

^[28] OIKA, Raporti Vjetor 2024, faqe 17, shkurt 2025.

^[29] OIKA, Ministër dil nënshkruaj!, maj 2024.

^[30] Radio Evropa e Lirë, Kuvendi dështon sërish ta miratojë Projektligjin për shëndetin riprodhues, shtator 2024.

^[31] Kallxo.com, Fertilizimi i asistuar mjekësor – Kur, ku e si do të ofrohet?, tetor 2024.

^[32] Kallxo.com, Protestë para Kuvendit të Kosovës lidhur me Projektligjin për shëndetin riprodhues, shkurt 2024.

^[33] Radio Evropa e Lirë, E drejta e prindërimit në duart e deputetëve, mars 2024.

Shëndeti mendor

Në Raportin e Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2024 theksohet se gjendja e shëndetit mendor mbetet kritike për shkak të mungesës së ambienteve të përshtatshme dhe masave të nevojshme të sigurisë në klinikat psikiatrike.^[34] Sipas këtij raporti buxheti i ndarë për shëndetin mendor në Kosovë ishte 4,077,437 euro për vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 është planifikuar një rritje e lehtë në 4,236,172 euro, rritje që do të shkoj kryesisht për paga dhe nuk mund të sjellë ndonjë përmirësim domethënës në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.^[35]

Në Kosovë, rreth 49.5% e grave përjetojnë shenja të depresionit pas lindjes, sipas një studimi të vitit 2025 që përdori shkallën EPDS i realizuar me 192 gra brenda 6 muajve pas lindjes.^[36] Sipas kësaj analize nivelet e larta të depresionit lidhen ngushtë me mungesën e mbështetjes sociale, statusin ekonomik dhe moshën e re të nënave.

^[34] Human Rights Network, *Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut 2024*, faqe 19, maj 2025.

^[35] Human Rights Network, *Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut 2024*, faqe 50, maj 2025.

^[36] Gashi, L. J., Fetahu, D., Sutoj, B., Sahatqija, M., & Selimi, X., *Prevalence and predictors of postpartum depression in women in Kosovo*, Women's Health (London), 2025.

Diskriminimi i ndërthurur

Gratë e komuniteteve etnike jo shumicë

Sipas një artikulli të shkruar nga zëvendës drejtorja e Rrjetit të organizatave të grave Rome, Ashkalike, Egjiptiane, 90% e grave nga këto komunitete jo-shumicë në Kosovë nuk kanë pasur asnjëherë një punë. Edhe kur punojnë, përballen me sfida si informaliteti, paga të ulëta, si dhe trajtohen ndryshe për shkak të përkatësisë etnike sidomos në ngritje në detyrë në punë.^[37]

Sa i përket pjesëmarrjes digjitale në shërbime dhe qasje në përgjithësi, te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian barrierë kryesore (100%) është kostoja e qasjes në internet dhe e pajisjeve, mirëpo edhe gratë boshnjake e shohin gjithashtu koston si shqetësimin e vetëm (100%). Në anën tjetër gratë serbe përballen me barrierat e koston (55%) dhe disponueshmërisë së shërbimeve (45%).^[38]

^[37] *Telegrafi, Sfidat e punësimit të grave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, dhjetor 2024.*

^[38] *UN Women, Profili Gjiner i Kosovës, faqe 79, nëntor 2024.*

Gratë LGBTI+

U bënë më shumë se 3 vite që kur Projekt-Kodi Civil u sjell për herë të parë në votim në Kuvend të Kosovës, e që i njëjti dokument ligjor do të mundësonte rregullimin ligjor të bashkësive civile të personave me seks të njëjtë me ligj të veçantë. Në ditën zero-diskriminim, më 1 mars të vitit 2024, pesë organizata të shoqërisë civile dorëzuan padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit për shkak të cenimit të dinjitetit dhe diskriminimit të personave LGBTIQ+ gjatë seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ishte mbajtur me 16 mars 2022.^[39]

Në tetor të vitit 2024, Avokati i Popullit hartoi një Opinion në lidhje me ankesën ku sipas tij "Avokati i Popullit vlerëson se deklaratat e deputetëve të bëra më 16 mars 2022, gjatë debatit në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, gjatë shqyrtimit të nenit të Projekt Kodit Civil, nr. 08/L-124, lidhur me nenin 1138, paragrafi 2, "janë diskriminuese, shkelin dinjitetin e personave LGBTIQ+ duke krijuar një mjedis poshtërues dhe fyes ndaj tyre, dhe duke u bazuar në praktikën e GjEDNJ përbëjnë gjuhë urrejtjeje ndaj komunitetit LGBTIQ+."^[40]

Edhe 5 vite nga ndarja e buxhetit për ndërtimin e strehimores për personat LGBTIQ+, ky projekt nuk u jetësua, e që shpeshherë personat LGBTIQ+ detyrohen të kërkojnë strehim në Shqipëri.^[41]

Në një diskutim të organizuar nga Dylberizm në dhjetor të vitit 2024, u tha se për ndërtimin e kësaj strehimoreje deri më tani nuk ka pasur vullnet politik nga institucionet, e sidomos nga Komuna e Prishtinës.^[42]

Edhe në vitin 2024 personat transgjinnorë në Kosovë vazhduan të mos kenë qasje në qendrat dhe klinikat e specializuara që ofrojnë kujdes shëndetësor për ofrimin e terapisë hormonale apo të operacioneve kirurgjike për afirmimin e gjinisë.

^[39] OIKA, *Organizatat për të drejtat e njeriut ngrisin padi kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deputetes Labino të Demi Murtezi*, mars 2024.

^[40] YILIR KS, *Opinioni i Avokatit të Popullit, dhjetor 2024*.

^[41] Dylberizm, *Personat LGBTIQ+ në Kosovë kanë nevojë urgjente për një strehimorë*, janar 2024.

^[42] Dylberizm, *Tëshilli i Evropës: Strehimorja LGBTIQ+ është urgjencë sociale dhe e drejtë papërbushur e njeriut*, dhjetor 2024.



Foto nga Parada e Krenarisë 2024
Credits: Prishtina Pride

Gratë me aftësi të kufizuara

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Gratë (UN Women) raporton se gratë me aftësi të kufizuara përballen me sfida të shumta në qasjen në shërbimet shëndetësore, veçanërisht ato që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues.^[43] Mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave i detyron gratë me dëmtime në dëgjim të mbështeten te familjarët për ndihmë, e rrjedhimisht kjo interferon me privatësinë dhe saktësinë e informacionit. Stigmatizimi dhe trajtimi i papërshtatshëm është evident te gratë me aftësi të kufizuara, ku shpesh ato janë rekomanduar nga gjinekologu që të mos mbesin shtatzënë për shkak të aftësisë së kufizuar, rekomandime të dhëna pa ekzaminim të duhur.^[44]

Gratë me shami

Në gusht të vitit 2024, Gjykata Themelore në Prizren, dega në Suharekë shpalli fajtor Liman Bytycin për veprën penale “shkelje e statusit të barabartë të shtetasve të Republikës së Kosovës”, dhe e gjykoi me dënim me kusht duke i’a vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.^[45] Sipas vendimit, Bytyçi në cilësinë e drejtorit të shkollës, duke e keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij, i mohon të drejtën për shprehje të lirë të identitetit dhe ushtrimin e autonomisë fetare Ramize Elezit. Kjo ndodh pasi e dëmtuara, e cila punonte si mësimdhënëse e matematikës, paraqitet për herë të parë në shkollë me mbulesë fetare, dhe Bytyçi, në rolin e drejtorit, i ndalon hyrjen në objekt.

^[43] UN Woman, *Profili Gjinnor i Kosovës*, nëntor 2024, Faqe 44.

^[44] Po aty.

^[45] Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, *Aktgjykimi P.nr. 453/2022*, gusht 2024.

Edhe në vitin 2024, vendimi për ndalimin e shamisë në shkolla ngjalli debat e polemika. Në fillim të vitit shkollor, me 2 shtator, vajza me inicialet A.D. është larguar nga procesi mësimor nga autoritetet shkollore të gjimnazit "Bedri Pejani" në Pejë për shkak të bartjes së shamisë, raporton Radio Evropa e Lirë.^[46] Sipas drejtorit të shkollës largimi është bërë në përputhje me Udhëzimi Administrativ 6/2014 të Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa në këtë artikull ishte raportuar se Prokuroria Themelore e Pejës po heton nëse ky veprim përmban ose jo elemente të veprës penale: shkelje e të drejtave të njeriut.^[47] Nxënësja me inicialet A.D. ishte kthyer në shkollë në fund të muajit shtator nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Pejës dhe drejtoria e Gjimnazit "Bedri Pejani", duke u bazuar në një shkresë të pranuar nga MASHTI.^[48]

^[46] Radio Evropa e Lirë, Ndalimi i shamisë në shkolla ngjall polemika për të drejtat dhe rregullat, shtator 2024.

^[47] Po aty.

^[48] Kallxo.com, Kthimi i nxënësës me mbulesë në Gjimnazin "Bedri Pejani" a tha Ministria e Arsimit "Shamia nuk konsiderohet mbulesë fetare"?, tetor 2024.

Dhuna me bazë gjinore

Në dhjetor të vitit 2024 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka prezantuar sistemin e hallkave elektronike për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të dyshuar për dhunë në familje. Hallkat do të vendosen në duar apo këmbë dhe do të monitorohen nga Policia e Kosovës për të parandaluar afërsi me viktimat.^[49]

Dhuna me bazë gjinore ndaj komuniteteve LGBTIQ+

Strukturat shoqërore dhe ligjore, që e trajtojnë seksin dhe gjininë si kategori të pandryshueshme dhe binare në vendin tonë bëjnë që të mos flitet rreth dhunës me bazë gjinore ndaj individë që nuk përshtaten me ndarjet binare të seksit dhe gjinisë.^[50] Sipas një artikulli të publikuar në web-faqen e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës gjatë vitit 2023–2024 janë raportuar 5 raste të dhunës ndaj komuniteteve LGBTIQ+ në Policinë e Kosovës, e për këto raste nuk ka ndonjë kategorizim të veçantë.^[51]

Sipas Qendrës për Barazi dhe Liri (CEL), kur dhuna ndaj grave ndërthuret me homofobinë dhe transfobinë, ajo intensifikohet dhe shfaqet në forma që mbeten jashtë vëmendjes së kornizave ligjore dhe protokolleve institucionale.^[52]

Për praktikën e punës sociale në Kosovë CEL rekomandon ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme për punëtorët socialë dhe profesionistët e shërbimeve sociale, me qëllim rritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj personave LGBT+.^[53] Gjithashtu, theksohet nevoja për hartimin dhe zbatimin e protokolleve standarde, duke siguruar një qasje të unifikuar institucionale në trajtimin e këtyre rasteve.

^[49] OIKA, *Lansohet sistemi i hallkave për mbikëqyrje elektronike, dhjetor 2024*.

^[50] AGK, *Realiteti i Padukshëm i Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, janar 2025.

^[51] Po aty.

^[52] CEL, *Nën Spektrin e Padukshëmrisë*, 2024.

^[53] CEL, *Puna Sociale në Trajtimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore: Personat LGBT+*, faqe 22, 2025.

Dhuna në familje ndaj grave

Sipas statistikave të publikuar nga Policia e Kosovës për vitin 2024, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuar ishte 2,959, një rritje prej 321 rastesh krahasuar me vitin 2023.^[54] Të dhënat tregojnë që 2,667 nga kryerësit ishin burra dhe 2,385 nga viktimat ishin gra.

Në anën tjetër Prokuroritë kanë pranuar 2014 raste të reja lidhur me veprën penale “dhuna në familje” ku viktimat janë gratë, me 2,169 persona.^[55] Nga këto raste, janë ngritur aktakuza për gjithsej 1,744 persona, për 114 persona është hedhur kallëzimi penal, për 90 persona është pushuar hetimi, për 36 persona është shqiptuar masa për trajtim të detyrueshëm, për 38 persona është bërë cedimi i kompetencës, ndërsa për 1 person është pushuar procedura për shkak të parashkrimit. Sipas informatave të siguruara nga QIKA, me vendim të gjykatës, 972 persona janë shpallur fajtorë, 14 persona janë liruar, 16 personave iu është refuzuar aktakuza, janë shqiptuar 17 masa të trajtimit të detyrueshëm dhe janë dhënë 9 aktgjykime me urdhër ndëshkues.

Në dhjetor të vitit 2024, Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë për “Dhunë në familje” ndaj Akil Gjakovës.^[56] QIKA përmes një reagimi shpreh zhgënjim për paraqitjen e Kryeministrit Kurti dhe Presidentes Osmani-Sadriu në ceremoninë e dorëzimit të flamurit për ekipin olimpiq, ku ata përmendën dhe vlerësuan xhudistin Akil Gjakova, i cili ishte nën hetim për dhunë në familje.^[57] Gjakova u denoncua nga bashkëshortja për dhunë fizike dhe psikologjike, në të cilin rast prokuroria kërkoi paraburgim, por gjykata e refuzoi dhe vendosi një ndalim-afërsie ndaj viktimes prej 50 metrash për një vit. QIKA thekson se ndërsa procesi gjyqësor është ende në vazhdim, mbështetja publike për një person tanimë të akuzuar për dhunë dërgon një mesazh të gabuar dhe zvogëlon rëndësinë e çështjes, andaj zyrtarët publikë duhet të jenë

^[54] Ministria e Drejtësisë, Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje.

^[55] QIKA, Përgjigjje e Këshilli Prokurorial i Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 25 mars 2025.

^[56] Botimi për Drejtësi, Dështon të nisë gjykimin për dhunë në familje ndaj Akil Gjakovës, janar 2025.

^[57] QIKA, Kryeministër dhe Presidente, mos e amistonit Akil Gjakovën, korrik 2024.

shembull duke treguar solidaritet me viktimat dhe duke promovuar drejtësinë dhe barazinë.

Në nëntor të vitit 2024 QIKA ka organizuar një aksion tek objekti i televizionit "Klan Kosova" i cili bëri bashkë në një show televiziv Atila Kardesh, i denoncuar në Policinë e Kosovës si i dyshuar për dhunë në familje, dhe viktimën, ish-partneren, Drenusha Latifi.^[1] Rrjeti i Organizatave për të Drejtat e Njeriut (HRN) e ka cilësuar këtë veprim si precedent të rrezikshëm që ritraumatizon viktimat e dhunës në familje.^[59]

Sipas QIKA, të mbijetuarat e dhunës në familje përballen me mungesë të konsiderueshme të mbështetjes institucionale, stigmatizim dhe pasiguri ekonomike, gjë që shpesh i detyron të mos raportojnë rastet e dhunës në familje ose të kthehen tek abuzuesit.

^[58] Kallxo.com, *Aksion tjetër para Klan Kosovës: "QIKA" kërkon që "të mos normalizohet dhuna", nëntor 2024.*

^[59] HRN, *Organizatrat anëtare të HRN kanë pranuar me shqetësim të thellë veprimet e Televizionit "Klan Kosova" dhe mënyrën se si ky televizion e trajton një rast të dhunës në familje në një reality show, nëntor 2024.*

Qasja në informata

Në mars të vitit 2025 ka hyrë në fuqi Udhëzim Administrativ (QRK) –Nr. 01/2025 për Linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjimore.^[60] Sipas këtij udhëzimi Linja Telefonike Emergjente do të jetë e qasshme 7 ditë të javës, 24 orë, dhe do të shërbej si pikë kontakti ndërlidhëse në nivel qendror për ofrimin e informacionit, këshillimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjimore. Kushtet për ofruesit e shërbimit dhe profesionistët e linjës janë caktuar me udhëzim si dhe trajnimet e monitorimi dhe inspektimi i këtyre të fundit. Ndërkohë një kapitull i veçantë në këtë dokument i kushtohet fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.^[61]

Ashtu si në vitet paraprake, edhe në vitin 2024 fushatat informuese nga institucionet për dhunën me bazë gjimore u përqendruan kryesisht gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinor.^[62]

^[60] Gazeta Zyrtare, Udhëzim Administrativ (QRK) –Nr. 01/2025 për Linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjimore, mars 2025.

^[61] Po aty.

^[62] Kallixa.com, Fushata “16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në bazë gjinore”, liderët e institucioneve theksojnë rëndësinë e fuzizimit të grave, dhjetor 2024.

Qasja në drejtësi

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) raporton se shumë persona që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore tërheqin ankesat e tyre si shkak i presionit familjar, e në anën tjetër ekziston një prirje mes anëtarëve të familjes dhe zyrtarëve për t'i fajësuar gratë që denoncojnë dhunën, gjë që i dekurajon edhe më tej nga kërkimi i ndihmës.^[43] Sipas kësaj organizate gratë që raportojnë dhunën në familje përballen me diskriminim të dyfishtë, si nga institucionet, ashtu edhe nga shoqëria dhe familja e tyre.

Sipas një raporti të monitorimit të publikuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) vihen në pah dy probleme kryesore në trajtimin institucional të rasteve të dhunës në familje: vonesat e seancave gjyqësore dhe mosrespektimi i afateve ligjore, si dhe zbatimi i dënimeve të lehta ose alternative.^[44]

Sipas gjetjeve në 24% të 29 seancave gjyqësore për urdhrat mbrojtës në procedurë civile, të monitoruara nga OSBE, janë shënuar shkelje të afateve procedurale, e kjo ka bërë që pothuajse një e katërta e viktimave të mos e marrin mbrojtjen e duhur në kohë, duke i lënë të ekspozuara ndaj rrezikut të vazhdueshëm të dhunës.^[45]

^[43] QKSS, *Strengthening Protection Mechanisms of Gender Based Violence in Kosovo*, faqe 2, 2024.

^[44] *Telegrafi*, OSBE: Vetëm 22% e rasteve të dhunës në familje përfundojnë me dënim me burg në Kosovë, 2024.

^[45] Po aty.

Qasja në strehimore

Në Ligjin për Buxhetin e vitit 2025, është paraparë një rritje e konsiderueshme e fondeve për Shpenzimet Bazike për Strehimoret duke arritur në 2,500,000€, kurse për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në 542,146€.^[66] Sipas organizatës RRGK, kjo rritje prej 67% e buxhetit për këto dy linja buxhetor është një shembull i ndikimeve pozitive gjinore.^[67]

Në 9 strehimoret e licencuara ndonëse viktimat marrin trajtime psikosociale, shëndetësore, këshillime dhe përfitojnë nga programet e riintegritimit në shoqëri, një problematikë serioze mbetet rikthimi i viktimave tek abuzuesit e tyre pas qëndrimit në strehimore.^[68] Sipas një publikimi të Amnesty International, mungesa e mbështetjes së mjaftueshme shtetërore dhe e strehimit social është një nga arsyt kryesore pse gratë dhe vajzat zgjedhin të mos raportojnë dhunën, ose detyrohen të qëndrojnë me abuzuesit e tyre, apo edhe të rikthehen tek ta.^[69]

Sipas Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), strehimoret për gratë në Kosovë përballen me sfida të sigurisë për shkak të mungesës së masave mbrojtëse si kamerat, siguri fizik dhe komunikimi direkt me policinë.^[70] Tutje ky publikim tregon se strehimoret kanë mungesa të mbështetjes afatgjate dhe politikave rehabilituese për viktimat dhe mungesë të njohurive dhe burimeve për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike, duke rrezikuar sigurinë dhe privatësinë e banoreve.^[71]

^[66] Gazeta Zyrtare, Ligjin Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës Se Kosovës Për Vitin 2025, dhjetor 2024.

^[67] Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Projektligjit për Buxhetin e vitit 2025 me Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës, nëntor 2024.

^[68] Asosacioni i Gazetarëve të Kosovës, Rikthimi Te Abuzuesi. Një Realitet i Rreth 80% Te Grave Në Kosovë, gusht 2024.

^[69] Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i përmbushë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, 2023.

^[70] QKSS, Strengthening Protection Mechanisms of Gender Based Violence in Kosovo, faqe 1, 2024.

^[71] Po aty.

Mbështetja pas qëndrimit në strehimore

Në vitin 2024, janë regjistruar 31 kërkesa në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale të Komunës së Prishtinës për mbështetje të viktimave të dhunës në familje, prej të cilave 7 janë refuzuar dhe 24 janë miratuar.^[72]

Sipas përgjigjes së Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në këtë Komunë, refuzimet ndodhin për shkak të mosplotësimit të kriterëve të kërkuara sipas vendimit në fuqi. Shumica e këtyre kërkesave vijnë nga komuna të tjera, për të cilat, megjithatë, edhe pse ka një dëshirë për të ofruar mbështetje, kjo drejtori nuk ka kompetencë apo përgjegjësi të trajtoj ato, sipas ligjit për vetëqeverisje lokale. Ky kufizim ligjor pengon mundësinë e mbështetjes për viktimat që nuk banojnë në territorin e drejtorisë, duke krijuar një barrierë për ofrimin e shërbimeve përtëj juridiksionit të caktuar thuhet në përgjigjen e marrë nga kjo Drejtori.

Edhe këtë vit kohëzgjatja e mbështetjes financiare për të mbijetuarat e dhunës në familje nga Komuna vazhdoi të lidhej me kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës.

Në nivel nacional ende vazhdon të mos ketë një program që mbështet financiarisht të mbijetuarat e dhunës në familje, duke lënë kështu një boshllëk në mbështetje për viktimat.

^[72] OIKA, Përgjigjeje e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale Komuna e Prishtinës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 25 mars 2023.

Qasja në punësim e grave që kanë përjetuar dhunë në familje

Në nëntor të vitit 2024 gjatë një diskutimi të organizuar në kuadër të fushatës “16 ditë të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, Ministria e Drejtësisë Albulena Haxhiu njoftoi se 58 viktimat të dhunës në familje aplikuan për “Masën për mbështetjen e punësimit të grave viktimat të dhunës” që ishte lansuar në nëntor të vitit 2023.^[73]

Sipas organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UN Women), riintegrimi i viktimave të dhunës në familje, veçanërisht përmes strehimit dhe punësimit, mbetet një sfidë, pasi mungesa e pavarësisë ekonomike shpesh i detyron ato të kthehen tek abuzuesit si zgjidhjen e vetme, ndërsa kushtet ekonomike luajnë një rol kyç në justifikimin dhe tolerimin e dhunës nga gratë.^[74]

E në dhjetor të vitit 2023, Qeveria e Kosovës pati lansuar masën për punësimin e grave të mbijetuar nga dhuna në familje, e cila parashikon subvencionimin e 70% të pagës së tyre për gjashtë muaj.^[75]

^[73] Kallxo.com, Cfarë po bën Qeveria për punësimin e të mbijetuarave të dhunës në familje?, nëntor 2024.

^[74] UN Women, Profili Gjinnor i Kosovës, faqe 34, nëntor 2024.

^[75] Radio Evropa e Lirë, Qeveria ndan fonde për punësimin e grave të mbijetuar nga dhuna, dhjetor 2023.

Dënimet e ulëta ndaj abuzuesve të grave

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) analizoi 57 aktgjykime të dhunës në familje nga gjykatat në Kosovë ku ndër këto raste janë shqiptuar gjithsej 38 dënime alternative.^[76] Sipas analizës, në 22.8% të rasteve, autorët janë recidivistë, ndërsa në 50% të aktgjykimeve nuk përmendet nëse autorët kanë qenë recidivistë apo jo.

Edhe OSBE realizoi një hulumtim rreth rasteve të dhunës në familje të cilat klasifikohen sipas nenit 248 të Kodit Penal, ku sipas analizës së nëntë rasteve, vetëm 22% përfunduan me dënim me burg, me një mesatare prej pak më shumë se pesë muaj, ndërsa në 78% të rasteve u aplikuan masa alternative si gjoba (mesatarisht 350€), dënime me kusht (mesatarisht gjashtë muaj e gjysmë) ose masa të tjera, përfshirë trajtim psikiatrik të detyrueshëm.^[77]

OSBE raporton se Gjykatat shpesh nuk vlerësojnë siç duhet rrethanat rënduese dhe lehtësuese në aktgjykimet e tyre, çka mund të shkelë kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare dhe vetë qëllimin e dënimit, i cili synon parandalimin e dhunës, kompensimin e viktimave dhe rehabilitimin e kryesve të veprave.^[78]

^[76] GLPS, *Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje*, faqe 29, nëntor 2024.

^[77] OSBE, *Raport nga Monitorimi i Gjykimeve të Rasteve të Dhunës në Familje në Kosovë*, faqe 13, korrik 2024.

^[78] Po aty.

Dhuna seksuale

Ndonëse u premtua në vitin 2024, funksionalizimi i qendrës për referim për trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale nuk është jetësuar ende.^[79]

Dhunimi seksual

Në shkurt të vitit 2025 organizata të shumta të shoqërisë civile kanë reaguar pasi për herë të katërt, e mitura, e njohur nga publiku si viktimat 11 vjeçare e dhunimit seksuale nga pesë burra në vitin 2022, është dhunuar përsëri. Kësaj here, dhunuesit janë dhjetëra persona, ndërsa katër prej tyre janë arrestuar nën dyshimin për trafikim me qenie njerëzore.^[80]

Nisur nga ky rast, Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist organizoi një aksion rrugor me grafito në qytetin e Prishtinës me mbishkrime që reflektojnë jetën e pasigurt për gratë në Kosovë dhe dështimin institucional për t'i mbrojtur ato.^[81]

Në një reagim nga Rrjeti i Grave të Kosovës përveç kërkesave urgjente lidhur me rastin e sipërpërmendur, kërkohet nga institucionet që "urgjentisht të themelohet qendra për trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale, ashtu siç kërkon edhe Konventa e Stambollit dhe Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale (i hartuar nga RrGK në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë)".^[82]

^[79] Dukagjini, *Ndonëse u premtua Qendra e Referimit për rastet e dhunimeve ende nuk është gati*, mars 2025.

^[80] Rrjeti i Grave të Kosovës, *Dështimet institucionale bëjnë viktimat e dhunës seksuale, viktimat të trafikimit, shkurt 2025*.

^[81] Kallxo.com, *Grafito në Prishtinë për rastin e 11 vjeçares*, mars 2025.

^[82] Rrjeti i Grave të Kosovës, *Dështimet institucionale bëjnë viktimat e dhunës seksuale, viktimat të trafikimit, shkurt 2025*.

Dhuna seksuale gjatë luftës

Që nga fillimi i procesit e deri me 15 mars 2025, 1748 persona kanë marrë statusin "viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës", prej të cilëve/ave 1650 gra dhe 98 burra.^[83] Vetëm gjatë vitit 2024, Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës ka pranuar gjithsej 183 aplikacione, të cilat janë shqyrtuar plotësisht nga Komisioni, duke miratuar 105 prej tyre dhe refuzuar 62.^[84]

Në maj të vitit 2024 Gjykata Themelore në Prishtinë u njohu pensionin e dyfishtë, pensionin si të mbijetuar/a të dhunës seksuale gjatë luftës dhe pensionin bazik të moshës (si dhe atë kontributdhënës), tre të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë 1998-99.^[85]

Në janar të vitit 2025 u ngrit aktakuzë ndaj të pandehurit me inicialet C.K, i nacionalitetit serb për dhunë seksuale si krim i luftës ndaj një viktime të nacionalitetit shqiptar.^[4] Ndërkohë që edhe në gusht të vitit 2024 Prokuroria Speciale e Kosovës raportoi se ngriti aktakuzë kundër të pandehurit Z.N, i nacionalitetit serb, për dhunë seksuale ndaj një viktime të nacionalitetit shqiptar.^[86]

Në tetor të vitit 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka publikuar raportin Ex-Officio nr. 436/2023 lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat e realizimit të beneficioneve të përcaktuara me ligj.

^[83] OJKA, Përgjigjje e Komisionit ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 27 mars 2025.

^[84] OJKA, Përgjigjje e Komisionit ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 27 mars 2025.

^[85] Radio Evropa e Lirë, *Gjykata ua nje pensionin e dyfishtë tre të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, maj 2024*.

^[86] Sitemi Prokurorial, *Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë për krime të veprës penale: "Krim i luftës kundër popullsisë civile"*, janar 2025.

^[87] Prokuroria Speciale, *Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër një të pandehuri, për krime lufte, gusht 2024*.

Sipas raportit legjislacioni dytësor ka boshllëqe ligjore dhe është propozuar ndryshimi i Rregullores Nr. 22/2015 për të garantuar të drejtat e personave të prekur dhe ushtrimin efektiv të mjeteve juridike. IAP ka shprehur shqetësim në lidhje me intervistimin e viktimave të dhunës seksuale, duke theksuar rrezikun e shkeljes së konfidencialitetit dhe mos ruajtjes së identitetit të tyre dhe ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse të sigurojnë trajtim dinjitoz për aplikuesit/et, duke shmangur ritraumatizimin gjatë intervistimit.^[88]

Dhoma e Sigurt është funksionalizuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë në mënyrë që viktimat e dhunës seksuale të luftës të dëshmojnë në gjykatë.^[89]

^[88] Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport i Avokatit të Popullit Ex-Officio nr. 436/2023, tetor 2024.

^[89] Gjykata Themelore Prishtinë, Sot në ambientet e Gjykatës Themelore në Prishtinë zyrtarisht është inauguruar "Dhoma e Sigurt", mars 2025.

Ngacmimet seksuale

Përgjatë vitit 2024, 53 raste të ngacmimit seksual janë raportuar në Policinë e Kosovës, 49 nga viktimat ishin gra dhe 83 nga të dyshuarit/at ishin burra.

2024	Gra	Burra	Panjour
Raportimet	46	6	1
Të dyshuar/a	1	83	1
Viktima	49	1	0

Në mars të vitit 2024, 27 studente të Fakultetit të Mjekësisë denoncuan profesorin Xhevat Krasniqi për ngacmim seksual në Këshill të Etikës.^[91] Rreth një muaj më vonë Këshilli i Etikës dhe rekomandimin për suspendimin e profesorit,^[92] e në tetor të vitit 2024 u raportua që pezullimi nga puna në Universitetin e Prishtinës (UP) të njëjtit i vazhdohet deri në përfundimin e hetimeve nga Prokuroria.^[93]

Një numër i protestave u organizuan nga aktivistë/e të Lëvizjes Feministe Studentore para objektit të Rektoratit të UP, duke bllokuar kështu edhe hyrjen e objektit me qëllim trajtimi të duhur të rastit dhe me kërkesë për përgjykimin e Krasniqit, e të njëjtat u shpërndanë me forcë nga policia.^[94] Në prill të vitit 2025 Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë për ngacmim seksual ndaj Xhevat Krasniqit.^[95]

^[91] OJKA, Përgjigjeje e Policisë së Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 25 mars 2025.

^[92] OJKA, 27 studente denoncojnë për ngacmim seksual një profesor, mars 2024.

^[93] OJKA, Këshilli i Etikës jep rekomandimin për suspendimin e profesorit Xhevat Krasniqi, prill 2024.

^[94] Kallxo.com, I vazhdohet pezullimi nga puna në UP profesorit Xhevat Krasniqi, tetor 2024.

^[95] Kallxo.com, Policia e Kosovës shpërndanë me forcë aktivistët që bllokuan hyrjen e Rektoratit të UP-së, prill 2024.

^[96] OJKA, Ngatet aktakuzë për ngacmim seksual ndaj Xhevat Krasniqit, prill 2025.



Foto nga protestat e studentëve dhe aktivistëve para Rektoratit të UP-së
Credits: Lëvizja Feministe Studentore

Sipas një ankete të realizuar nga profesorja e Departamentit për Punës Sociale në Fakultetin Filozofik në UP, Njomza Llullaku, me 1,035 studentë, prej të cilëve 73.9% vajza dhe 20.4% djem, 10.4% e studentëve të anketuar, shumica vajza, deklaruan se kanë përjetuar ngacmime seksuale në UP kryesisht nga profesorë e asistentë.^[96]

Në nëntor të vitit 2023 Zyra e Kryeministrit publikoi Manualin për zbatimin e politikës kundër ngacmimit seksual në organet e Administratës Publike.^[97]

Një çështje tjetër shqetësuese është se ngacmimi seksual dhe sulmi seksual shpesh trajtohen si të njëjta dhe ngatërrohen, kurse në një hulumtim të realizuar më gjyqtarë/e në Kosovë, shumica e intervistuarve/ave nuk ishin në dijeni se sipas Kodit të ri Penal ngacmimi seksual është vepër penale.^[98]

^[96] Kallxo.com, Hulumtimi që nxori shifra shqetësuese të ngacmimeve seksuale në UP, tetor 2024.

^[97] Telegrafi, Publikohet manuali që lufton dhe parandalon ngacmimin seksual në sektorin publik, nëntor 2023.

^[98] UN Woman, Profili Gjiner i Kosovës, faqe 38, nëntor 2024.

Dhuna përmes teknologjisë informative

Organizata Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) ka propozuar që “Dhuna Kibernetike në Baza Gjimore” të futet në nenin 249 të Kodit Penal të Kosovës si vepër e re penale konform Direktivës së Bashkimit Evropian për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.^[99] Sipas RRGK dhuna kibernetike është bërë një kërcënim serioz për gratë dhe vajzat. Forma të dhunës kibernetike në baza gjimore janë: përndjekja kibernetike, nxitja kibernetike e dhunës ose urrejtjes në baza gjimore, shfaqja e padëshiruar e përmbajtjes së papërshtatshme në internet ose TIK, zbulimi i informacionit personal (“Doxing”), përdhunim virtual.^[100]

Në maj të vitit 2024 u raportua se grupi “Alb Kings” përmes të cilit shpërndaheshin të dhëna personale e video intime denigruese, kryesisht të vajzave dhe grave, u byllë përfundimisht, e shtatë persona u arrestuan.^[101] Megjithatë, një muaj më vonë Sinjali raportoi se grupi denigruer është rihapur.^[102] Në mars 2025, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar Florent Poroshticën, një nga të akuzuarit për krijimin dhe menaxhimin e grupit “Albkings”, me 21 muaj burgim dhe një gjobë prej 5 mijë eurosh.^[103]

Sipas një hulumtimi të publikuar nga Demokracia për Zhvillim (D4D) gratë përballen më shpesh me dhunë dhe ngacmim në internet, kryesisht nga burrat. Sipas të dhënave, 89.6% e komenteve me gjuhë të urrejtjes shkruhen nga burra, ndërsa 10.4% nga gratë.^[104]

^[99] Rrjeti i Grave të Kosovës, Propozimet për futjen e Dhunës Kibernetike në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, gusht 2024, faqe 4.

^[100] Po aty.

^[101] OIKA, Mbyllet përfundimisht grupi “Albkings”, maj 2024.

^[102] Sinjali, Rihapet “Albkings”- grupi denigruer ndaj grave e vajzave, qershor 2024.

^[103] OIKA, Dënohet me 21 muaj burgim dhe 5 mijë euro gjobë administratori i grupit “Albkings”, mars 2025.

^[104] Demokracia për Zhvillim, Mediat e sociale, janar 2024.

Gratë në sferën publike

Demokracia për Zhvillim (D4D) përmes raportit “Mediat jo-sociale” ka identifikuar një trend shqetësues të dhunës online ndaj grave politike në Kosovë që sipas tij tregojnë një model në rritje të fushatave të dezinformimit gjinor, të dizajnuara posaçërisht për të sulmuar gratë në pozita politike.^[105] Sipas D4D gratë janë target përmes formave të ndryshme të dhunës, por kryesisht mizogjinisë të shprehur në tekste dhe online.

Në nëntor të vitit 2024 gratë deputete të Kuvendit të Kosovës nënshkruan një deklaratë të përbashkët për të luftuar dhunën kundër grave në politikë dhe jetën publike.^[106]

Zyra e organizatës QIKA është sulmuar në qershor të vitit 2024, pas publikimit të emisionit “Ngjyrat e Dashurisë”, vendosjes në ballkon të flamurit të komuniteteve dhe raportimeve mbi Javën e Krenarisë.^[107] Logo pranë zyrës së QIKA-s është vandalizuar me ngjyrë të zezë nga persona të panjohur.

Juristja e medias dhe aktivistja Flutura Kusari edhe në 2024 ishte cak i sulmeve verbale. Këtë herë nga deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje Dimal Basha.^[108] Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka konsideruar sulmin ndaj Kusarit si të papranueshëm, të rrezikshëm dhe me bazë gjinore.

^[105] Demokracia për Zhvillim, *Mediat jo-sociale*, faqe 8, janar 2024.

^[106] Kuvendi i Kosovës, *U nënshkrua Deklarata kundër dhunës ndaj grave në politikë në Kosovë, nëntor 2024*.

^[107] QIKA, *Sulmohet zyra e QIKA nga homofobët, qershor 2024*.

^[108] Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, *Të papranueshme dhe të rrezikshme sulmet e deputetit Dimal Basha ndaj medieve dhe aktivistes Flutura Kusari, qershor 2024*.



Foto nga vandalizimi i logos të QIKA-s, gjatë Javës së Krenarisë
Credits: QIKA

Femicidi

Në qershor të vitit 2024 Ministria Haxhiu ka njoftuar që ka inicuar hartimin e Projektligjit Kundër Femicidit.^[109] Sipas statistikave, përgjatë vitit të raportimit në Kosovë u vranë 3 gra.^[110]

Erona Cokli (21 vjeçe)

Erona Coklin e vranë me 12 prill 2024 brenda zyrës së Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj. Më 4 shtator 2024 Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti aktakuzë ndaj Valon Aliu për veprat penale “Vrasja e rëndë”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve” dhe “Kanosja” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.^[111] Sipas raportimit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj ekziston dyshimi i bazuar se Valon Aliu me dashje ka privuar nga jeta tani të ndjerën Elona Cokli.^[112] Në tetor, i akuzuari është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të vrasjes së rëndë dhe atë të kanosjes.^[113]

Sipas Kallxo.com, Valon Aliu i akuzuari për vrasjen e Elona Coklit kishte të kaluar kriminale. Ai më parë ishte i dënuar për veprat penale: lëndim i lehtë trupor (2007), lëndim i rëndë trupor (2012), blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale (2016), nxitja e akteve seksuale me premtimin e rrejshme për martesë (2021), kanosje (2022).^[114]

^[109] Kallxo.com, *Ministria e Drejtësisë inicion hartimin e Projektligjit kundër femicidit, qershor 2024.*

^[110] Ministria e Drejtësisë, *Databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje*

^[111] Prokuroria Themelore në Ferizaj, *Aktakuzë për vrasjen e rëndë në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj, shtator 2024.*

^[112] Po aty.

^[113] *Betimi për Drejtësi, Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për vrasjen e ish-bashkëshortes në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj, tetor 2024.*

^[114] Kallxo.com, *E kaluara kriminale e Valon Aliu, të dyshuarit për vrasjen e 21-vjeçares në Ferizaj, prill 2024*

Gjyljeta Ukella (43 vjeçe)

Gjyljeta Ukella u vra me 16 prill 2024 në banesën e saj nga bashkëshorti i saj Edmond Lajqi. Dorasi ishte vetëdorëzuar në Polici.^[115] Në nëntor ishte ngritur aktakuzë për vrasësin ndërsa i njëjti në seancën e dhjetorit kishte pranuar fajsinë.^[116] Me 27 dhjetor 2024, Gjykata Themelore në Pejë ka dënuar me burgim të përjetshëm Edmond Lajqin për vrasjen e Gjyljeta Ukellës.^[117] Vendimi ishte mirëpritur nga familjarët.

M.ZH (43 vjeçe)

Një grua tjetër me inicialet M.Zh., nga Gushterica e Poshtme e komunës së Graçanicës, ka vdekur në gusht të vitit 2024 si pasojë e lëndimeve të rënda që dyshohet që i ka shkaktuar partneri i saj.^[118]

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDDLNJ) thekson se rasti në Graçanicë mund të ishte shmangur po të kishte pasur një koordinim më të mirë mes institucioneve.^[119]

Ky rast nxiti aktiviste/ë të mbajnë një aksion rrugor në Prishtinë pranë Stacionit të Policisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës nën slloganin “Po i vrisni gratë”.^[120] Një tjetër protestë kundër femicidit dhe dhunës ndaj grave u mbajtë para Stacionit Policor në Graçanicë me 2 gusht.^[121]

Për të marrë informacione në lidhje me këtë rast konkret, QIKA ka kontaktuar Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe pastaj edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, mirëpo në një përgjigje të këtij të fundit refuzohet qasja në shkresa të lëndës sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2025 për Publikimin e Vendimeve Gjyqësore që ndalon publikimin e vendimeve gjyqësore të natyrës penale në rastet në të cilat veprat penale janë kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare.^[122] Në përgjigjen në kërkesë të KGJK thuhet se “Duke marr parasysh se ne rastin tuaj, bëhet fjalë për një vepër penale e kryer në kuadër të marrëdhënieve gjegjësisht kontekstit familjar, pra lëndim i rëndë trupor me pasoja fatale ndërmjet gruas dhe partnerit të saj,

ju njoftojmë se në bazë të dispozitës së cituar më lart, KGJK, nuk mund të lejoj qasje në shkresat e kësaj lënde, përkatësisht në aktakuzën në fjalë, të kërkuar nga ana e juaj.”

^[104] Radio Evropa e Lirë, Burgim i përjetshëm për të akuzuarin për vrasjen e bashkëshortes në Pejë, dhjetor 2024.

^[105] Po aty.

^[106] Po aty.

^[107] Betimi për Drejtësi, Gruaja nga Graçanica vdes në spital, dyshohet se burri e rrahu dhe i shkaktoi lëndime të rënda, gusht 2024.

^[108] OIKA, KMDLNJ dënon rastet e dhunës në familje, gusht 2024.

^[109] OIKA, Aksion simbolik në Prishtinë “Po i vrisni gratë”, gusht 2024.

^[110] Radio Evropa e Lirë, Në Graçanicë protestohet kundër femicidit dhe dhunës ndaj grave, gusht 2024.

^[111] OIKA, Përgjigjia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ndaj kërkesës për qasje në informata publike, 15 maj 2025.

Zhvillimet në vitin 2024 rreth rasteve të tjera të femicidit në Kosovë

Liridona Ademaj (30 vjeçe)

Në nëntor 2023, një person e vrau me armë zjarri Liridona Ademajn gjersa ajo ishte në makinë me partnerin e saj dhe fëmijët e tyre. Me 15 janar 2025 Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë ndaj Naim Murselit (partneri i Liridones), Kushtrim Kokallës, Granit Plavës dhe Tom Dodajt për vrasjen e Liridona Ademajt.^[123] Në seancën fillestare të mbajtur më 31 janar 2025, Naim Murseli ishte deklaruar i pafajshëm për akuzat që e ngarkojnë, Kushtrim Kokalla nuk është deklaruar pa u konsultuar me avokatin, Granit Plava është mbrojtur në heshtje, ky i fundit konsiderohet personi që ka shtënë me armë për të vrarë Liridona Ademaj.^[124] I akuzuari në këtë rast për veprën penale shitje e paautorizuar e armëve, Tomë Dodaj, është dënuar me 5 vjet burgim dhe 5000 euro gjobë pasi ka pranuar fajësinë.^[125]

Maria Clara Urdangaray (27 vjeçe)

Sipas Kallxo.com Endrit Nikës të dyshuarit për vrasjen e Maria Clara Urdangaray në maj të vitit 2024 i është vazhduar paraburgimi edhe për dy muaj të tjerë.^[126] Maria Clara Urdangaray, shtetase argjentinase vdiq pasi kishte rënë nga një lartësi e një objekti në gusht të vitit 2023.

^[123] Botimi për Drejtësi, Prokuroria ngrit aktakuzë ndaj Naim Murselit dhe tre të tjerëve për vrasjen e Liridona Ademajt, janar 2025

^[124] Kallxo.com, Vrasja e Liridona Ademajt - Krejt çka ndodhi në seancën ndaj Naim Murselit dhe të akuzuarve tjerë, janar 2025.

^[125] Kallxo.com, Vrasja e Liridona Ademajt - 5 vjet burgim ndaj Tomë Dodajt për "shitjen e paautorizuar të armës, janar 2025.

^[126] Kallxo.com, Rrëfimi i nënës së argjentinases që dyshohet se u vra në Kosovë, maj 2024.

Marigona Osmani (18 vjeçe)

Marigona Osmanin e vranë me 21 gusht të vitit 2021. Gjykata Themelore në Ferizaj dënoi me burgim të përjetshëm Dardan Krivaqën për vrasjen e Marigona Osmanit, ndërsa Arbër Sejdiu e dënoi me 15 vite burgim për ndihmë në vrasje. Ndonëse Gjykata e Apelit, në shkurt 2024, e anuloi vendimin e Themelores dhe e ktheu rastin në rivendosje,^[127] Gjykata Themelore në Ferizaj në korrik të vitit 2024 shpalli aktgjykim dënues edhe në rigjykim ndaj Dardan Krivaqës, duke e dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e Marigona Osmanit dhe të akuzuarin Arbër Sejdiu e dënoi me 15 vite burgim për ndihmë në vrasjen e rëndë në bashkëkryerje.^[128]

Mirjeta Zeka (41 vjeçe)

Edhe 6 vite nga zhdukja e Mirjeta Zekës rasti nuk është zbardhur ende. Në prill të vitit 2022 Betimi për Drejtësi pati raportuar se sipas informatave Prokuroria Themelore në Mitrovicë kishte pezulluar hetimet për rastin e Mirjeta Zekës dhe raportohej se do të rifillojnë kur të eliminohen shkaqet të cilat kanë shkaktuar pezullimin.^[129] Organizatat e shoqërisë civile kanë publikuar një deklaratë të përbashkët me rastin e 6-vjetorit të zhdukjes së Mirjeta Zekës.^[130] Sipas deklaratës, neglizhenca e institucioneve në këtë rast dëmton rëndë besimin e qytetarëve në drejtësi. Organizatat kërkuar që rasti të transferohet nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë në Prokurorinë Speciale të Kosovës, duke marrë parasysh dështimin e deritanishëm për ta trajtuar rastin dhe për të sjellë drejtësi për Mirjetën. Mirjeta Zeka është shpallur e zhdukur që nga 31 marsi 2019 në Mitrovicë.

^[127] Gjykata e Apelit, Anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda ndaj të akuzuarve D.K dhe A.S ndërsa çështja kthehet në rigjykim, 25 shkurt 2024,

^[128] Betimi për Drejtësi, Edhe në rigjykim Dardan Krivaqa dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjen e Marigona Osmanit, korrik 2024.

^[129] Betimi për Drejtësi, Mirjeta Zeka gati që katër vjet e zhdukur. Prokuroria ende pa asnjë rezultat për zbardhje të rastit dhjetor 2022.

^[130] OIKA, Deklarate e përbashkët, mars 2025.

Diana Kastrati (27 vjeçe)

Edhe në vitin 2024 nuk u raportuan zhvillime të reja për gjetjen dhe sjelljen para drejtësisë të vrasësit të Diana Kastratit. Adnan Jashari, ish-partneri i Diana Kastratit, është i dyshuari kryesor për vrasjen e saj me armë zjarri në Prishtinë me 18 maj 2011. Pas vrasjes, ai u arratis nga Kosova dhe Policia nuk arriti ta arrestojë.

